



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2019 – Numri: 36

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 25 mars 2019

## PËRMBAJTJA

|  | Faqe   |
|--|--|
| Dekret i Presidentit<br>nr. 11146, datë 18.3.2019                | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 1589   |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 11147, datë 19.3.2019                | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 1589   |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 145, datë 20.3.2019      | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar..... 1589  |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 154, datë 27.2.2019      | Për disa ndryshime në vendimin nr. 633, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”..... 1591 |
| Vendim i Bankës së Shqipërisë<br>nr. 20, datë 13.3.2019          | Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga OTP Bank Nyrt, Hungari, të 88.89 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Societe General Albania sh.a..... 1592  |
| Vendim i Bankës së Shqipërisë<br>nr. 21, datë 13.3.2019          | Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga Banka Union sh.a. të 100 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a..... 1592   |
| Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 86, datë 20.3.2019 | Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 1593   |
| Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 87, datë 20.3.2019 | Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 1595   |

Vendim i Komisionit Qendror të  
Zgjedhjeve nr. 88, datë 20.3.2019

Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Vlorë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....

1597

**DEKRET**

Nr. 11146, datë 18.3.2019

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme

**DEKRETOJ:**

## Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Orjana Bujar Beqaj
2. Klodian Ndue Kola
3. Olsa Sabri Refugjati
4. Meral Fatmir Knapp (Kiço)
5. Donald Hasan Cenameri
6. Jurgen Sami Seci
7. Shkurte Maliq Uka
8. Ardita Xhelal (Dželal) Jonuzi
9. Ersilio Bujar Nishani

## Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Ilir Meta

**DEKRET**

Nr. 11147, datë 19.3.2019

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, me propozim edhe të Ministrisë së Brendshme

**DEKRETOJ:**

## Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Shqiprim (Ściprim) Izir Taipi

2. Geraldo Blerim Bajrami
3. Veton Hilmi Haradinaj
4. Bjondina Musa Ibrahim Haradinaj (Ibrahimi)
5. Aldo Natale Marino
6. Odette Gilbert Marquet
7. Elbenita Mustafë Kajtazi Halimi (Kajtazi)
8. Serhan Hasan Gerçek
9. Qamil Brahim Kroni
10. Miradije Hamit Kroni (Luma)

## Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Ilir Meta

**VENDIM**

Nr. 145, datë 20.3.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA  
NË VENDIMIN NR.953, DATË 29.12.2014,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT  
NR.92/2014, ‘PËR TATIMIN MBI VLERËN  
E SHTUAR NË REPUBLIKËN E  
SHQIPËRISË’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 159, të ligjit nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

## Neni 1

Në aneksin 1 hiqen nënndarjet me kodet tarifore të mëposhtme:

84244100; 84244910; 84248210; 84289071;  
84322100; 84322930; 84321000; 84322910;  
84322990; 84322950; 84323100; 84323911;  
84323919; 84323990; 84368010; 84324100;  
84324200; 84328000; 84335100; 84335200;  
84334000; 84332010; 84332050; 84332090;  
84331110; 84331159; 84331190; 84331959;  
84331970; 84331990; 84333000; 84335310;  
84335330; 84335911; 84335919; 84341000;



84335100; 84361000; 84371000; 87011000;  
87019110; 87019210; 87019310; 87019410;  
87019510; 84193100.

#### Neni 2

Pas aneksit 1, shtohet aneksi 1/A, “Lista e makinave bujqësore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

#### Neni 3

Fjalía e parë, e pikës 3, të nenit 8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Lista e makinerive dhe pajisjeve, që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin, është e përcaktuar në anekset 1 e 2, ndërsa lista e makinave bujqësore, sipas shkronjës “n”, të nenit 51, të ligjit nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është përcaktuar në aneksin 1/A, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

#### Neni 4

Në aneksin 4, “Lista e kategorive të inpueteve bujqësore”, shtohen inputet bujqësore sipas kodeve tarifore, të përcaktuara në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

#### Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Erion Braçe**

Tabela

| Kategoria e inpueteve | Kodi 8-shifror | Emërtimi 8-shifror  |
|-----------------------|----------------|---|
| Pesticide             | 38086100       | -- Në paketime me një peshë neto jo më tepër se 300 g                         |
| Pesticide             | 38086200       | -- Në paketime me një peshë neto më tepër se 300 g, por jo më tepër se 7.5 kg |
| Pesticide             | 38086900       | -- Të tjera   |

#### ANEKSI 1/A

#### LISTA E MAKINAVE BUJQËSORE TË PËRJASHTUARA NGA TVSH-JA NË IMPORT DHE BRENDA VENDIT

1. Pompa spërkatëse (sprucuesit), tërheqëse ose të varura në traktor, të pajisura me motor elektrik, me djegie të brendshme ose që marrin fuqinë nga

traktori ose vetëlëvizëse me motor individual (kodet sipas NKM-së 84244100, 84244910).

2. Pompa ujitëse tërheqëse ose të varura në traktor, të pajisura me motor elektrik, me djegie të brendshme ose që marrin fuqinë nga traktori, dhe impiantet vaditëse për fusha të hapura, sera ose pemtore (kodet sipas NKM-së 84248210).

3. Pirunë ngritës për përdorim në bujqësi (kodet sipas NKM-së 84271010).

4. Ngarkuesit dhe shtytësit që montohen në traktorë (kodet sipas NKM-së 84289071).

5. Lesat me dhe pa disk (kodet sipas NKM-së 84322100, 84322930).

6. Plugjet (kodet sipas NKM-së 84321000);

7. Kultivatorët (kodet sipas NKM-së 84322910).

8. Shkriftuesit (kodet sipas NKM-së 84322910).

9. Rulat për lëndina (kodet sipas NKM-së 84322990).

10. Rotovatorë (freza, grirëse degësh dhe bari) (kodet sipas NKM-së 84322950).

11. Farëmbjellës, bimëmbjellës, zhardhokmbjellës, transplantues bujqësore me dhe pa frezim, me dhe pa precision (kodet sipas NKM-së 84323100, 84323911, 84323919, 84323990).

12. Makinat e mbjelljes dhe shkuljes së fidanëve dhe pemëve (kodet sipas NKM-së 84368010).

13. Shpërndarësit e plehrave kimike (kodet sipas NKM-së 84324100, 84324200).

14. Makina përpunuese të plehut organik, pastruese, përzierëse, transportuese dhe shpërndarëse; (kodet sipas NKM-së 84328000).

15. Makina korrje apo shirje (kodet sipas NKM-së 84335100, 84335200).

16. Presat për ambalazhimin e dengjeve të kashtës apo tagjisë (kodet sipas NKM-së 84334000).

17. Makinat korrëse të barit të njomë apo të thatë, që tërhiqen ose marrin fuqinë nga traktori ose të vetëdrejtuara, me ose pa motor (kodet sipas NKM-së 84332010, 84332050, 84332090).

18. Kositëse për lëndinat me ose pa motor, elektrike apo me djegie të brendshme, të vetëdrejtuara ose të tërhequra nga traktori (kodet sipas NKM-së 84331110, 84331159, 84331190, 84331959, 84331970, 84331990).

19. Krasitëse që montohen në traktor ose tërhiqen nga traktori, me bateri ose ajër, me dhe pa depozita ajri, vjelësit e specializuar dhe transportuesit e specializuar (të vëna në lëvizje nga traktori ose me motor individual); Kodi sipas NKM-së 84368010; 84388099).



20. Lidhëse dhe ambalazhim të barit të thatë ose të njomë (kodet sipas NKM-së 84333000).

21. Shkulëse të rrënjëve ose zhardhokëve, panxharit etj., me motor dhe pa motor të tërhequra nga traktori ose jo (kodet sipas NKM-së 84335310, 84335330).

22. Korrësit e foragjereve dhe silazhuesit me motor dhe pa motor, të vetëdrejtuar ose të tërhequra nga traktori (kodet sipas NKM-së 84335911, 84335919).

23. Mjelësit e qumështit, sistemet e përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit të bagëtive dhe shpendëve (kodet sipas NKM-së 84341000).

24. Makinë korrije shirje e kombinuar; makineri për përgatitjen e ushqimeve të kafshëve (kodet sipas NKM-së 84335100; 84361000).

25. Makinat për seleksionimin dhe klasifikimin e farave, drithërave apo fruta-zarzavateve (kodet sipas NKM-së 84371000).

26. Motokultivatorët e ndryshëm me një aks (kodet sipas NKM-së 87011000).

27. Traktorë bujqësorë me goma dhe me zinxhirë (kodet sipas NKM-së 87019110, 87019210, 87019310, 87019410, 87019510, 87013000).

28. Tharësit për produktet bujqësore (kodet sipas NKM-së 8419 31 00).

*Shënim: Përfshirja nga TVSH-ja është për makinat bujqësore, të cilat kanë përsëritjen sipas kësaj liste dhe kodin tarifor përkatës.*

## VENDIM

Nr. 154, datë 27.2.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 633, DATË 26.10.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MASAT KUNDËR NDOTJES SË AJRIT NGA SHKARKIMET E MJETEVE MOTORIKE DHE REDUKTIMIN E SHKARKIMEVE NË AJËR TË NDOTËSVE TË GAZTË DHE TË LËNDËS SË NGURTË PEZULL NGA MOTORËT ME NDEZJE POZITIVE DHE ATA ME NDEZJE ME KOMPRESION QË DJEGIN GAZ NATYROR APO TË LËNGSHËM PËR PËRDORIM NË AUTOMJETE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3, të nenit 13, të ligjit nr. 162/2014, “Për

mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, të nenit 79, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 633, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Shkronja “c”, e pikës 8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Autoveturat e përdorura, të gjitha ato që nuk janë me zero km dhe që janë regjistruar më parë për qarkullim në rrugë në një shtet tjetër, të cilat përmbushin normën Euro 4.”.

b) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Automjetet e blera para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, që janë nisur për t'u çliruar për qarkullim të lirë dhe regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe që kanë hyrë në territorin shqiptar brenda datës 31.12.2018 dhe nuk kanë përfunduar procedurat doganore dhe të regjistrimit, kanë afat deri në 31 dhjetor 2019, për kryerjen e procedurave të nevojshme.”.

c) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Ngarkohen autoritetet doganore të kontrollojnë dokumentacionin shoqëruar të mjetit motorik dhe të ndalojnë importin e mjeteve motorike që nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 4 dhe 8, të këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, autoritetet doganore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

**VENDIM**

Nr. 20, datë 13.3.2019

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT  
PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN NGA  
OTP BANK NYRT, HUNGARI, TË 88.89  
PËR QIND TË KAPITALIT AKSIONAR  
TË BANKËS SOCIETE GENERAL  
ALBANIA SHA**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të shkronjës “gj”, të pikës 1, të nenit 24, si dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të japë miratimin paraprak për zotërimin e 88.89 për qind të aksioneve me të drejtë vote, të kapitalit aksionar të Bankës Societe General Albania sh.a. nga OTP Bank Nyrt, Hungari.

2. Ngarkohet Banka Societe General Albania sh.a. të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përmbushjen nga palët të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të kontratës për shitblerjen e aksioneve.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI  
Gent Sejko**

**VENDIM**

Nr. 21, datë 13.3.2019

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT  
PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN NGA  
BANKA UNION SHA TË 100 PËR QIND  
TË KAPITALIT AKSIONAR TË BANKËS  
NDËRKOMBËTARE TREGTARE SHA**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e” të nenit 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të shkronjës “gj” të pikës 1 të nenit 24, si dhe të nenit 25 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

**VENDOSI:**

1. Të japë miratimin paraprak për zotërimin e 100 për qind të aksioneve me të drejtë vote, të kapitalit aksionar të Banka Ndërkombëtare Tregtare sh.a. nga Banka Union sh.a.

2. Ngarkohet Banka Union sh.a. të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përmbushjen nga palët të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të kontratës për shitblerjen e aksioneve.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI  
Gent Sejko**



## VENDIM

Nr. 86, datë 20.3.2019

### **PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM, QARKU TIRANË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 20.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri - kryetar;  
Denar Biba - zv.kryetar;  
Bledar Skënderi - anëtar;  
Edlira Jorgaqi - anëtare;  
Rezarta Bitri - anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, znj. Klajda Theodhoraq Gjoshja.

**KËRKUES:** Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

#### VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore, qarku Tiranë, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 qershor 2017, ka fituar 5 (pesë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Tiranë, është numri rendor 1 (një) znj. Klajda Theodhoraq Gjoshja, numri rendor 2 (dy) znj. Kejdi Fatmir Mehmetaj, numri rendor 3 (tre) znj. Floida Fadajev Kërpaçi, numri rendor 4 (katër) z. Endrit Vullnetar Braimllari dhe numri rendor 5 (pesë) z. Luan Mersin Rama.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Tiranë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. KQZ-ja, me vendimin nr. 288, datë 5.5.2017 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2017”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për 12 zonat zgjedhore, si dhe vendosi sanksion administrativ në masën 1.000.000 (një) milion lekë për zonën zgjedhore qarku Tiranë.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në zonën zgjedhore qarku Tiranë, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatit e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Tiranë, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë) z. Ralf Dhimitër Gjoni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen,



emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 607 prot., datë 27.2.2019, z. Ralf Dhimitër Gjoni, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Ralf Dhimitër Gjoni, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, më datë 12.3.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2117.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Ralf Dhimitër Gjoni, rezulton se, në pikën 8, të formularit të vetëdeklarimit, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj?”, ka deklaruar si më poshtë vijon:

09/1994 - 08/1998, ka jetuar në Colchester, UK, në adresën: Heath RD, Stanway, CO3 5QZ Colchester, UK, për arsye studimi;

09/1998 – 11/2000, ka jetuar në Lyon, Francë, në adresën: Cours Emile Zola, 69100 Villeurbanne, për arsye studim/punësim;

12/2000 – 07/2001, ka jetuar në Barcelonë, Spanjë, në adresën: Carrer D’Entenca, 08015, Barcelonë, Spanjë, për arsye profesionale;

09/2001 – 06/2004, ka jetuar në Phoenixville, PA, USA, në adresën: Eland Downe Phoenixville, PA, 19460, USA, për arsye punësimi;

09/2004 – 06/2008, ka jetuar në Londër, UK, në adresën: Greycoat, Gardens, Greycoat, ST, Londër, SE1P 2QB, UK, për arsye studim / punësim.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreu V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1429 prot., datë 13.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1431

prot., datë 13.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Ralf Dhimitër Gjoni, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V779/1 prot., datë 18.3.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Ralf Dhimitër Gjoni, sipas së cilës rezultoi se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ralf Dhimitër Gjoni, rezultoi se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidadit vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar në listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë), z. Ralf Dhimitër Gjoni.

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, pika 2, nenin 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

#### VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Tiranë, z. Ralf Dhimitër Gjoni.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR  
Klement Zguri





## VENDIM

Nr. 87, datë 20.3.2019

### **PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM, QARKU FIER, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 20.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri - kryetar;  
Denar Biba - zv.kryetar;  
Bledar Skënderi - anëtar;  
Edlira Jorgaçi - anëtare;  
Rezarta Bitri - anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Petrit Kozma Vasili.

**KËRKUES:** Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

#### VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit të zonës zgjedhore, qarku Fier, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të

radhës në listën shumëmemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 qershor 2017, ka fituar 2 (dy) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Fier, është numri rendor 1 (një) z. Petrit Kozma Vasili dhe numri rendor 2 (dy) z. Robert Thoma Bitri.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Fier, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin vijues të listës së partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, fjalë e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në zonën zgjedhore qarku Fier.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Petrit Kozma Vasili, qarku Fier, i ka kërkuar kandidatit vijues të listës shumëmemërore me numër rendor 2 (dy), znj. Erisa Piro Xhixho dorëzimin e formularit të vetdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin 50, datë 12.3.2019 ka vendosur, të shpall moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Fier, znj. Erisa Piro Xhixho.



Në bazë të nenit 164, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Fier, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 4 (katër), z. Nimet Aqif Musaj.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Z. Nimet Aqif Musaj, referuar ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, më datë 12.3.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2118.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Nimet Aqif Musaj, rezulton se, nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1429 prot., datë 13.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1431 prot., datë 13.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Fier, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Nimet Aqif Musaj, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V-779/1 prot., datë 18.3.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Fier, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Nimet Aqif Musaj, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Nimet Aqif Musaj, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Rezulton se me vendimin nr. 945, datë 15.7.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, z. Nimet Aqif Musaj i është dhënë mandati i anëtarit të këshillit bashkisë Fier, i subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, qarku Fier, Bashkia Fier. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar vendimi i Këshillit Bashkiak Fier nr. 18, datë 19.3.2019, për miratimin e dorëheqjes nga funksioni i anëtarit të Këshillit Bashkiak Fier, të z. Nimet Aqif Musaj dhe shpalljen e vakancës në Këshillin Bashkiak.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidadit të parë i gjinisë përkatëse në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në zonën zgjedhore qarku Fier, i renditur me numër rendor 4 (katër), z. Nimet Aqif Musaj.

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

#### VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Fier, z. Nimet Aqif Musaj.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR  
Klement Zguri



**VENDIM**

**Nr. 88, datë 20.3.2019**

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË  
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË  
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS  
SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA  
SOCIALISTE PËR INTEGRIM, QARKU  
VLORË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS  
SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I  
SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 20.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri - kryetar;  
Denar Biba - zv.kryetar;  
Bledar Skënderi - anëtar;  
Edlira Jorgaqi - anëtare;  
Rezarta Bitri - anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Vlorë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Sezai Feta Rokaj.

**KËRKUES:** Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**VËREN:**

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit të zonës zgjedhore, qarku Vlorë, të subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të

radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 qershor 2017, ka fituar 1 (një) mandat dhe kandidati fitues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Vlorë, është numri rendor 1 (një) z. Sezai Feta Rokaj.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Vlorë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, me kandidatin vijues të listës së partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, fjalia e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në zonën zgjedhore qarku Vlorë.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Sezai Feta Rokaj, qarku Vlorë, i ka kërkuar kandidatit vijues të listës shumemërore me numër rendor 2 (dy), z. Sokol Durim Dervishaj dorëzimin e formularit të vetdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin 58, datë 12.3.2019 ka vendosur, të shpall moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Vlorë, z. Sokol Durim Dervishaj.

Në bazë të nenit 164, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë



Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Vlorë, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet, me numër rendor 3 (tre) znj. Enada Dilo Kapllani (Koçiraj).

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 1433 prot., datë 13.3.2019, znj. Enada Dilo Kapllani (Koçiraj) është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Znj. Enada Dilo Kapllani (Koçiraj), referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 18.3.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2121.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të znj. Enada Dilo Kapllani (Koçiraj), rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime. Në seksionin I.B të formularit të vetëdeklarimit, gjenealitete të mëparshme, ka deklaruar ndryshime në mbiemrin: Koçiraj.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1519 prot., datë 19.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1520 prot., datë 19.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Vlorë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Enada Dilo Kapllani (Koçiraj), që ka dorëzuar formularin

e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V-806/1 prot., datë 19.3.2019 zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Vlorë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Enada Dilo Kapllani (Koçiraj), sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të znj. Enada Dilo Kapllani (Koçiraj), rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatis të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në zonën zgjedhore qarku Vlorë, i renditur me numër rendor 3 (tre), znj. Enada Dilo Kapllani (Koçiraj).

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

#### VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatis të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Vlorë, znj. Enada Dilo Kapllani (Koçiraj).

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

**KRYETAR  
Klement Zguri**

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë